



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2024:208045

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06097273

P.nr.283/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit J.M., nga Vushtrria, te cilin sipas autorizimit e mbron av. Amir Bunjaku e av. Latif Hyseni, për shkak te veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit i Përgjithshëm PP-II-nr.1257/2024 të datës 02.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 13.08.2024 po te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 28.08.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

J.M. nga i ati B... dhe nëna K..., e vajzërisë I..., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna e Skenderajt tani, me vendbanim në Vushtri rrugën "...", i martuar, prind i katër fëmijëve, i vetë punësuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë Më datë 23.07.2024, rreth orës 10:30, në Rr. "..." përkatësisht në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, *e kanos personin zyrtar lidhur me punën e tij zyrtare dhe atë pozita e personit zyrtar M.H.*, në atë mënyrë që, derisa *i dëmtuari ka qenë duke ushtruar detyrën e tij zyrtare, gjatë seancës në fjalën përfundimtare* familjarët e familjes M... kishin prishur rendin në gjykatore ku ..., tani i dëmtuari kishte urdhëruar policinë që t'i largoj nga salla tani të pandehurin J.M., vëllaun e tij E... dhe axhën A... *dhe në një moment i pandehuri J...* duke dal nga salla e gjykimit *duke ia drejtuar gishtin* kanos të dëmtuarin me fjalët *"te kam kallzu edhe ne ditët e para ti e ke ne dore me vendos kta"*, *"mbaje në mend qita qe po me qet jasht, ja ki me i gjyku edhe 4 – 5 tjerë"*, me çka i dëmtuari është ndjerë i rrezikuar dhe i kanosur nga i pandehuri,

Me këtë ka kryer veprën penale **Kanosje nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, (kodi 06/L-074)**

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 44 si dhe nenin 181 par.3 lidhur me par. 1 te KPRK-se si dhe neni 364, 452 dhe nenit 462 te KPPK-së Gjykata i cakton:

DËNIM ME BURG

Me të cilin të akuzuarit J.M. i **CAKTOHET dënimi me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.**

Koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt. nga data 23.07.2024 e deri me datë 13.08.2024, do ti llogaritet ne dënimin shqiptuar.

Me pëlqimin e te pandehurit e ne vështirim te dispozitave te nenit 44 te KPRK-së, gjykata, pjesën e mbetur te dënimit me burgim, te pandehurit ia zëvendëson me,

DËNIM ME GJOBË

Me te cilin dënim, gjykata te pandehurit i cakton gjobën ne shumen prej 1800€ (njëmijetëqind euro).

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 70€, ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 20€, si dhe ne emër te shpenzimeve te transportit shumen prej 60€.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP-II-nr.1257/2024 të datës 02.08.2024, kundër të pandehurit J.M. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 186 par. 3 lidhur me par. 1 nën të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.08.2024. Te pandehurit i është lexuar aktakuza PP-II-nr.1257/2024 e datës 02.08.2024 nga ana e prokurorit te shtetit dhe i njëjti është deklaruar se e kupton ne tërësi aktakuzën. Ne seancën e shqyrtimit fillestar ne te cilën prezent ka qenë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësit e tije sipas autorizimit, i pandehuri është njoftuar me te drejtat e tija ne kuptim te dispozitave te nenit 241 te KPP-së. Ne kuptim te dispozitave te nenit 242 te KPP-së, pasi qe gjyqtari i vetëm gjykues është

bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit i është dhënë mundësia të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë sipas aktakuzës.

I pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij ka deklaruar se don ta pranojë fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe i kërkon falje shumë ... – të dëmtuarit, se veprimin e ka bërë prej nervozes dhe presionit dhe i vjen shumë keq. Ka theksuar se nuk ka asnjë rrezik që ta përmbushi kanosjen e bërë në asnjë formë, por që veprimi i tij ka qenë vetëm shprehje e ngarkesës, nervozes së çastit. Gjykatën e ka lutur që ti shqiptojë një dënim sa më të butë duke pasur parasysh situatën në të cilën ai ka qenë, pasi e ka pasur një anëtarë të familjes të humbur, gjegjësisht axhën, për çka është ndjerë shumë keq, por që të dëmtuarit – ... nuk do ti ndodhë asnjë e keqe kurrë nga ana e tij dhe është penduar shumë për atë që ka ndodh.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka njoftuar për dënimet e parapara, se nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtrojë prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese, gjykata paraprakisht e ka njoftuar te pandehurin rreth benefiteve lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, është bërë në mënyrë vullnetare dhe i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë dhe i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Tutje prokurori i shtetit ka theksuar se nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij lidhur me pranimin e fajësisë se të pandehurit ka deklaruar se i pandehuri J.M. pranimin e fajësisë për veprën e cila i ngarkohet nga prokuroria, e ka bërë me vullnetin e tij të plotë, pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatët mbrojtës dhe i penduar për veprën që është kryer, andaj gjykatës i propozojmë që të pranojë pranimin e fajësisë

si dhe njëherit në qoftë se nuk ka seancë të veçantë për rrethanat lehtësuese dhe rënduese, atëherë i rikujtojmë gjykatës që i pandehuri veprën e kryer e ka bërë në rrethana tejet emocionale, pasi përveç që ka marrë pjesë në një shqyrtim gjyqësor ku ka mbetur i vrarë mixha i tij, ditën e njëjte ka qenë edhe përvjetori i vrasjes së tij, po ashtu për këtë i pandehuri i premtojë gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëritet asnjëherë një veprim i tillë, shprehu keqardhje dhe pendim, po ashtu i njëjti është mbajtës i familjes së tij, po ashtu edhe jetimëve të cilët e humbën babain e tyre, i rikujtojmë gjykatës që i njëjti udhëheq biznes me të cilin varen edhe punëtorët përveç familjarëve të tij. Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykatës i ka propozuar që i njëjti të jetë me kusht apo me gjobë pasi është i vetëdijshëm i mbrojturi dhe i penduar dhe ka ndjerë keqardhje.

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 242 par 1 të KPP-së dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovet nga ana e gjykatës si dhe ka pranuar deklarin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë, procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit në prokurori dt. 01.08.2024; raporti i oficerit dt. 23.07.2024; raporti i policit dt. 23.07.2024; deklarata e të dëmtuarit dhënë në polici dt. 23.07.2024; deklarata e dëshmitarit F.S. dhënë në polici dt. 23.07.2024; deklarata e të pandehurit dhënë në polici dt. 23.07.2024; informacionet e personit për të dyshuarin, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarinet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë, bashkëpunimin vullnetar të pandehurit gjatë hetimit dhe ndjekjes penale, kërkim faljen si dhe shprehjen e keqardhjes për veprën e kryer.

Gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 69 e 70 të KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar në rrethanat rënduese në vijim ku si rrethanë rënduese konsideroj, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale pasi që vepra penale është kryer në gjykatë, si dhe prezencën e kanosjes me dhunë, kurse rrethana të tjera rënduese gjykata në rastin konkret nuk gjeti.

Në nenin 181, par.1, të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Kanosja të cilën veprën e kryen “Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktit të ankthit të personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.” Kurse si formë e kualifikuar e kësaj veprës penale është dispozita e nenit 181 par 3 ku qëndron se “Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.” e që në rastin konkret në veprimet e të pandehurit është kryer pikërisht kjo formë e kualifikuar e veprës penale.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar me burgim dhe i zëvendësuar me dënim me gjobë si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se nuk ka pasur vend që ne rastin konkret të shqiptohet dënim me te ashpër apo me te butë. Gjykata vlerëson se dënimi me burgim dhe i zëvendësuar me dënimin me gjobë është i domosdoshëm në mënyre që të arrihet qëllimi i dënimit si ne dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, si dhe të arrij ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e ka bazuar në nenin 462 të KPPK.

Nga të lartë cekurat e bazuara në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.283/24, datë: 28.08.2024

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.